

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5442
E mërkurë, 4 prill 2018
çmimi 0.40 €

Kuvendi pritet të diskutojë për deportimin e shtetasve turq ■ FAQE 3

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Grupi i Deputetëve të Pavarur (GDP) kanë mbledhur 40 nënshkrime për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për deportimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AKTUALE

PADIJA DHE GRYKËSIA JANË KRYEPROBLEMET TONA F. 6



Shkruan: Jakup KRASNIQI

ARRESTOHEN TRE PERSONA, KONFISKOHEN ARMË, DROGË, AUTOMJETE DHE PARA F.7

BYTYQI: ME PROJEKTLIGJIN PËR INOVACION PËRFITOJNË TË RINJTË F.3

EKONOMI

AMERIKANËT TË INTERESUAR PËR PROJEKTE TË RICIKLIMIT DHE ENERGISË NË KOSOVË F.9

ILIR SHALA ZGJEDHET KRYESHEF EKZEKUTIV I KOSTT-it F.9

KULTURË

MOSHARRESA NË SHËRBIM TË KUJTESËS HISTORIKE F.13

Prof. dr. Sabahajdin CENA

SPORT

VUSHTRRIA, GATI TA BEFASOJË EDHE PRISHTINËN F.16

VOKRRI: MIQËSORJA ME SHQIPËRINË, E MUNDSHME F.16

FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAFER GASHI ■ FAQE 4-5

Asociacioni të jetë pa kompetenca ekzekutive



Zëvendëskryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Xhafer Gashi, ka thënë se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive dhe se duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe

Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky asociacion i ri duhet t'i ngjajë një OJQ-je sikurse është asociacioni aktual. Gashi ka bërë me dije se nëse

institucionet qendrore e shohin të nevojshme ndihmën e përfaqësuesve të Asociacionit të Komunave të Kosovës në këtë proces, do të jenë të gatshëm për ta dhënë kontributin tyre në këtë drejtim

AKR-ja pajtohet për largimin e Sefajt nga posti i ministrit

Flamur Sefaj i është përgjigjur kryeministrit Ramush Haradinaj duke dhënë dorëheqje nga pozita e ministrit të Punëve të Brendshme pas arrestimit dhe deportimit të gjashtë shtetasve turq në Turqi. Aleanca Kosova e Re (AKR) ka bërë

me dije se Sefaj nuk ka qenë faktor vendimmarrës dhe vetëm ka zbatuar ligjin përkitazi me kërkesën e AKI-së, institucion ky i cili, sipas Kushtetutës, ka vlerësuar se gjashtë shtetasit turq kanë përbërë rrezik për sigurinë nacionale të Kosovës



LDK-ja fton partitë politike për caktimin e datës për zgjedhje të reja



RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Hoxhaj: Vazhdimi i dialogut me Serbinë po bëhet i pamundur

PRISHTINË, 3 PRILL - Veprimet e fundit të Serbisë, duke përfshirë kampanjën e vazhdueshme kundër njohjes ndërkombëtare të Kosovës si dhe deklaratimet e fundit të kryeministres së Serbisë, Ana Brnabiç, në lidhje me pjesëmarrjen e Kosovës në Samitin e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor në Sofje, kanë nxitur reagimin e zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Kosovës, Enver Hoxhaj.

Përmes një postimi në "Twitter" Hoxhaj ka thënë se

veprime të tilla po e bëjnë të pamundur zhvillimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Më tej, Hoxhaj ka shkruar se Kosova do t'i ndërmarrë veprimet e saj në kundërpërgjigje të këtyre fushatave të Serbisë kundër Kosovës, sepse këto janë kundër normalizimit të marrëdhënieve. "Fushata agresive dhe sistematike për tërheqjen e njohjeve të Kosovës dhe dalja publike të Serbisë kundër pjesëmarrjes së Kosovës në

samitin e BE-së për Ballkanin Perëndimor, në Sofje, po e bëjnë të pamundur dialogun mes dy shteteve. Kosova do të kundërpërgjigjet ndaj këtyre veprimeve proporcionalisht, sepse të njëjtat janë kundër normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar Hoxhaj.

Kryeministria e Serbisë, Ana Brnabiç, ka deklaruar se për Serbinë është e pakuptimë pjesëmarrja e Kosovës në samitin në Sofje. Në anën tjetër, Qeveria e Serbisë



vazhdon të krenohet me njohjeve ndërkombëtare të punën e saj në tërheqjen e Kosovës.

Opozita e Shqipërisë kalon në mosbindje civile

Opozita e bashkuar shqiptare u ka bërë thirrje qytetarëve t'i bllokojnë rrugët dhe të mos paguajnë taksën rrugore prej pesë eurosh dhe konsideron se mosbindja civile është e vetmja formë proteste kundër Qeverisë

TIRANË, 3 PRILL - Opozita e bashkuar e Shqipërisë ka mbajtur të hënën në mbledhje një mbledhje ku ka marrë vendim unanimisht se mosbindja civile është e vetmja formë proteste kundër Qeverisë.

Lulzim Basha dhe Monika Kryemadhi, dy krerët e partive opozitare në Shqipëri, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, u kanë bërë thirrje qytetarëve t'i bllokojnë rrugët dhe të mos paguajnë taksën rrugore prej pesë eurosh. "Kemi dalë me një vendim unanimisht, në krah të qytetarëve, të njerëzve të thjeshtë të këtij vendi që po goditen, vidhen dhe përcëohen nga një bandë kriminale në pushtet", tha kreu i PD-së, Lulzim Basha.

Opozita ka paralajmëruar protestat deri sa kjo taksë të largohet, por edhe ka thënë se nuk ka tërheqje deri në rrëzimin e Qeverisë së kryeministrit Edi Rama. "Hapësira e vetme është mosbindja qytetare dhe kjo nis që këtë javë me refuzimin, të çdo taksë që ka rritur Edi Rama dhe me të gjitha hapat, format dhe mënyrat e mosbindjes qytetare si forma më e lartë e veprimit politik e qytetar, kundër një klike që po zbraps Shqipërinë", tha Basha.

Por, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, të martën ka reaguar përmes një postimi në "Facebook" duke akuzuar opozitën se po e "përdor Kukësin për ta djegur rrugën evropiane të Shqipërisë". "Kur ishin në Qeveri e bënë tenderin e pagesës së



rrugës 8-9 EU! Dështuan. Tani i vunë zjarrin 'patriotik' e duan ta përdorin Kukësin si shishe benzine për ta djegur rrugën evropiane të Shqipërisë. Mjerë kush u beson rrugëhumburve pa atdhe që duan zjarr e kaos për t'i ikur drejtësisë!", ka shkruar Rama.

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, në një konferencë për medie të martën, shprehu keqardhje për dhunën "e motivuar politikisht"

gjatë protestës në "Rrugën e Kombit" dhe tha se dëmi shkon në miliona euro.

Gjiknuri shtoi se rruga ende nuk ka përfunduar dhe ajo kërkon investim për mirëmbajtje, duke arsyetuar kështu tarifën prej pesë eurosh. "Taksa e qarkullimit nuk mjafton për ta mirëmbajtur. Është një aset i kushtueshëm", tha ai.

Ndërsa disa qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe deputetë të

opozitës, janë mbledhur para Drejtorisë së Policisë në Tiranë për ta kërkuar lirimin e personave të arrestuar pas protestës në Kukës. Ata shprehen të vendosur për të vijuar me këtë protestim deri në plotësimin e kërkesës së tyre kryesore, që është lirimi i të arrestuarve.

Të shtunën qindra protestues janë përplasur me Policinë e Shqipërisë pranë sporteve ku duhet të bëhet pagesa për taksën rrugore në "Rrugën e Kombit" në Kalimash.

Protestuesit kanë shkatërruar tërësisht kabinat e pagesës së tarifës, duke i goditur me mjete të forta dhe duke ua vënë zjarrin. Ata u mbledhën në protestë për ta kundërshtuar tarifën prej pesë eurosh në Kalimash, të cilën ata e konsiderojnë shumë të lartë.

Një ditë pas protestës, Policia e Shqipërisë arrestoi 23 persona në Kukës, që thuhet se janë përgjegjës për shkatërrimin e sporteve. Të arrestuarve pritet t'u shqiptohen masat e sigurisë të mërkurën në mëngjes.

Majko në Ankara, pritët në takim nga Çavushoglu

TIRANË, 3 PRILL - Zëvendëskryeministri i Turqisë, Hakan Çavushoglu, ka pritur në një takim ministrin e Diasporës të Shqipërisë, Pandeli Majko. Takimi vazhdoi i mbyllur për media pas marrjes së pamjeve dhe fotografive. Ndërkaq në Qendrën e Kulturës Shqiptare në Ankara, përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në Turqi, i uruan mirëseardhje ministrit Majko. Të pranishëm në Qendrën ku organizohen kurse e aktivitete të

shumta kulturore ishin përfaqësues të shoqatave shqiptare të tilla si, "Vatra" e "Çamëria", studentë e profesionistë që kishin mbërritur edhe nga qytete të tjera të Turqisë, si Stambolli dhe Izmiri.

Përfaqësuesit e komunitetit u shprehën të nderuar nga vizita e ministrit Majko, duke e cilësuar atë si pikënisjen e një bashkëpunimi të frytshëm me autoritetet shqiptare. Ndërsa i falënderoi për mikpritjen e ngrohtë, Majko përgëzoi diasporën në Turqi

për punën e bërë deri më tani, në mbrojtje të gjuhës dhe identitetit shqiptar. "Jemi në hapat e parë të një pune që ka nisur pa ne. Organizimi i shqiptarëve jashtë vendit, nuk është një risi; përpjekjet dhe arritjet e tyre janë të jashtëzakonshme. Por ne po mundohemi t'i çojmë përpara këto përpjekje, duke ndërtuar struktura dhe organizma që do të sanksionojnë me ligj marrëdhënien e shtetit shqiptar me diasporën", u shpreh Majko.



Kuvendi pritet të diskutojë për deportimin e shtetasve turq



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Grupi i Deputetëve të Pavarur (GDP) kanë mbledhur 40 nënshkrime për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për deportimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova. Opozita ka kërkuar që kjo seancë të mbahet sot (e mërkurë) në orën 14:00. Por, për këtë çështje do të vendosë Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e sotshme, e cila do të mbahet në orën 10:00

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINE, 3 PRILL - Kryesia e Kuvendit të Kosovës do të mbledhet sot (e mërkurë) në orën 10:00 për të vendosur lidhur me kërkesën e 40 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, në të cilën do të debatohet për rastin e deportimit të gjashtë shtetasve të Republikës së Turqisë. Kërkesa për debat parlamentar për deportimin e shtetasve turq është dorëzuar në Kryesinë e Kuvendit nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i mbështetur nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje si dhe Grupi i Deputetëve të Pavarur. Partitë opozitare kanë kërkuar që kjo seancë të mbahet sot (e mërkurë) në orën 14:00. Shefi i Grupit Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka kritikuar Kryesinë e Kuvendit për vonesat e mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme.

Ai ka thënë se mosharmonizimi i veprimeve institucionale dhe ikja nga përgjegjësia e krerëve institucionalë lidhur me rastin e deportimit të shtetasve turq po vazhdon edhe në trajtimin e kërkesës

për seancë edhe nga Kryesia, e cila, sipas Hotit, nuk po arrin t'i mbledhë anëtarët e saj për ta shqyrtuar kërkesën as në ditë pune. Po ashtu, Hoti ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit ta respektojë Rregulloren e Punës. "Të martën në orën 11:00 është dashtë të mbahet seanca e jashtëzakonshme për skandalin e deportimit joligjor të gjashtë shtetasve turq sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së, mbështetur edhe nga dy grupe të tjera parlamentare. Kryesia e Kuvendit nuk është mbledhur për të proceduar me këtë kërkesë dhe, si rezultat, seanca nuk mund të mbahet. Ne kemi dorëzuar një kërkesë tjetër që kjo seancë të mbahet sot (e mërkurë) në orën 14:00. Pres që kryetari i Kuvendit t'i respektojë normat e Rregullores të Kuvendit dhe vullnetin e 40 deputetëve dhe ta mbledhë sa më parë Kryesinë e Kuvendit për ta caktuar seancën", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Për rastin e shtetasve turq të martën ka folur edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, duke thënë se deportimi i tyre ishte një lloj vjedhjeje e njerëzve nga Kosova. Haradinaj ka thënë se nuk i kupton reagimet e presidentit turk ndaj tij, ndërsa ka

theksuar se askush nga jashtë nuk do të marrë vendime për punët e brendshme të Kosovës. "Kosova ka një kujdes në marrëdhëniet me të gjitha shtetet e tjera, edhe me Republikën e Turqisë. Jemi mirënjohës për njohje, për përkrahje në planin ndërkombëtar në punët e brendshme të ndonjë shteti tjetër, edhe të Republikës së Turqisë. Ndalimi i gjashtë shtetasve turq në Kosovë dhe deportimi i tyre ka paqartësi. Pra, mënyra e revokimit të lejes së qëndrimit është procedurë shumë e shpejtë, edhe deportimi i fshehtë. Bazuar në këtë dhe për faktin se nuk kam qenë i informuar, kam marrë

vendim dhe i kam shkarkuar parevokueshëm ministrin e Brendshëm dhe drejtorin e Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës. Reagimet e presidentit (Erdogan) nuk i kuptoj. Ne nuk ndërhyjmë në punët e brendshme të Turqisë. Këto janë punë të brendshme tonat dhe askush nuk do të ketë vendimarrje në punët e brendshme të Kosovës", ka thënë Haradinaj në një intervistë për "Zërin e Amerikës".

Familjarët e personave të deportuar në Turqi kërkojnë ndihmë nga deputetët

Familjarët e personave të deportuar kundërligjëshëm në Turqi përmes një letre kanë kërkuar ndihmë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës duke thënë se ndihen të rrezikuar. Ata kanë kërkuar nga deputetët aprovimin e masave ligjore të cilat do të mund të siguronin mbrojtje nga pasoja të kidnapimeve/deportimeve të kundërligjëshme për të gjithë shtetasit e huajt në Kosovë. Sipas tyre, Kosova, duke i arrestuar

gjashtë shtetasit turq, ka vepruar si një shtet i kapur dhe vasal. "Me shpresën që të bashkëndjeni me ne dhe ta kërkon rivendosjen e të drejtave tona kushtetuese në vend, ju bëjmë të ditur se ndihemi të rrezikuar si për vete, ashtu edhe për familjarët tanë të deportuar kundërligjëshëm në Turqi. Andaj, konform rendit kushtetues dhe kompetencave tuaja, kërkojmë nga ju që përmes veprimeve tuaja ta kërkon aprovimin e masave ligjore të cilat do të mund të siguronin mbrojtje nga pasoja të kidnapimeve/deportimeve të kundërligjëshme për ne dhe për të gjithë shtetasit e huajt në Kosovë të cilët ndodhën në situata të ngjashme me ne. Duke përfshirë këtu edhe plotësim-ndryshimin eventual të Ligjit për të Huajt, me qëllim të plotësimin të zbrazësive ligjore dhe kufizimit të kompetencave vetjake të institucioneve të caktuara të cilat kanë sjellë deri të kjo ngjarje e, fatkeqësisht, kemi frikën se ngjarje të njëjta mund të përsëriten", është thënë në letrën e familjarëve të personave të deportuar në Turqi.

DASH: Inkurajohemi që institucionet e Kosovës do ta shqyrtojnë rastin me shtetasit turq

Një zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), duke komentuar incidentin e fundit në mes të Kosovës dhe Turqisë, i ka thënë "Zërit të Amerikës" se ShBA-ja është e inkurajuar për faktin se institucionet shtetërore të Kosovës kanë njoftuar vendos-

mërinë e tyre për ta shqyrtuar këtë ngjarje dhe për t'i përmirësuar garantitë procedurale për mbrojtjen e të drejtave në bazë të procesit ligjor. Transparenca dhe angazhimi ndaj procesit të rregullt ligjor dhe sundimit të ligjit, ka thënë zëdhënësi i DASH-it, janë

jetike për zhvillimin demokratik të Kosovës dhe për aspiratat euroatlantike. Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit ka bërë me dije se për pyetje të tjera t'u drejtohem Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Turqisë.

Flet për "Epokën e re", Xhafer Gashi

Asociacioni të jetë pa k



Zëvendëskryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Xhafer Gashi, ka thënë se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive dhe se duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky asociacion i ri duhet t'i ngjajë një OJQ-je sikurse është asociacioni aktual. Gashi ka bërë me dije se nëse institucionet qendrore e shohin të nevojshme ndihmën e përfaqësuesve të Asociacionit të Komunave të Kosovës në këtë proces, do të jenë të gatshëm për ta dhënë kontributin tyre në këtë drejtim

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 PRILL - Zëvendëskryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Xhafer Gashi, ka bërë me dije se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të jetë pa kompetenca ekzekutive. Ai është shprehur i bindur se ky asociacion do të themelohet në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka thënë se nëse ky asociacion themelohet në këtë mënyrë, ai do të jetë vetëm një OJQ siç është edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. "Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive. Duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mendoj se kjo është rruga e duhur dhe më e mira e krijimit të këtij aso-

ciacioni", ka thënë Gashi. Ai nuk beson se në hartimin e statutit të këtij asociacioni do të merren parasysh kërkesat e Serbisë, që ai të ketë kompetenca shtesë. "Besoj se kjo nuk do të ndodhë, sepse një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës. Me siguri i keni dëgjuar edhe deklaratimet e Qeverisë së Kosovës se një gjë e tillë nuk do të ndodhë dhe se Asociacioni i Komunave me

Shumicë Serbe do të themelohet vetëm sipas Kushtetutës së Kosovës", është shprehur Gashi, duke shtuar se vetëm kjo mënyrë e themelimit të asociacionit të ri nuk do të provokonte ndonjë ndarje etnike në mes të komunave të Kosovës. Sipas tij, raportet në mes të dy asociacioneve duhet të jenë ashtu siç e parasheh ligji. "Ne jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe gjithherë këto bashkëpunime duhet të jenë vetëm në suaza të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës", ka deklaruar Gashi, i cili është edhe kryetar i Komunës së Obiliqit. Ai është zotuar se kryesia e re e Asociacionit të Komunave të Kosovës me përkushtim do të merrret me të gjitha shqetësimet e komunave në vend. "Ka shumë ligje të cilat duhet të

harmonizohen mes vete. Shqetësimet kryesore vijnë nga dhënia e kontributit për përpilimin e ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore. Pastaj, kemi problemin e Ligjit për miniera dhe minerale, ku asociacioni është inkuadruar dhe po punon në këtë drejtim. Po ashtu, është Ligji për dhënie e pronave në shfrytëzim dhe disa ligje të tjera. Pra, ligjet që janë në proces i marrim dhe i trajtojmë bashkërisht", ka thënë Gashi.

"Epoka e re": Z. Gashi, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka mbajtur Kuvendin e Përgjithshëm vjetor, në të cilin është zgjedhur kryetari i ri Agim Veliu dhe ju zëvendëskryetar, si dhe anëtarët e tjerë të bordit. Cilat janë synimet e bordit të ri të këtij asociacioni?

Gashi: Kemi mbajtur Kuvendin

kompetenca ekzekutive



e Përgjithshëm vjetor të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në të cilin është zgjedhur kryetar i ri Agim Veliu nga radhët e LDK-së, pasi kjo është partia që qeverisë më së shumti komuna në vend. Bordi ka gjithsej shtatë anëtarë, ku tre prej tyre i takojnë LDK-së, dy AAK-së, një PDK-së dhe një anëtar komunitetit serb. Në presim që javën e ardhshme të ulemi bashkërisht si udhëheqje e re dhe të fillojmë t'i shqyrtojmë të gjitha temat. Natyrisht se ne do t'i trajtojmë të gjitha kërkesat që vijnë nga komunat e Kosovës dhe të gjitha shqetësimet që ne i kemi të përbashkëta.

"Epoka e re": Meqenëse ju për dy mandate jeni kryetar i Komunës së Obiliqit, cilat janë shqetësimet më të mëdha të komunave?

Gashi: Ka shumë ligje të cilat duhet të harmonizohen mes vete. Shqetësimet kryesore vijnë nga dhënia e kontributit për përpilimin e ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore. Pastaj kemi problemin e Ligjit për miniera dhe minerale, në të cilin asociacioni ynë është inkuadruar dhe po punon në këtë drejtim. Po ashtu është Ligji për dhënie e pronave në shfrytëzim dhe disa ligje të tjera. Pra, ligjet që janë në proces i marrim dhe i trajtojmë bashkërisht.

"Epoka e re": Qeveria ka bërë me dije se ka filluar të merret me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Çfarë kontributi mund të japë asociacioni ekzistues për formimin e asociacionit të ri?

Gashi: Besoj se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të themelohet njësoj sikurse asociacioni ynë. Kjo nënkupton se edhe ai asociacion duhet të themelohet sipas ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës. Nëse institucionet qendrore e shohin të nevojshme ndihmën tonë në këtë proces, ne do të jemi të gatshëm për ta dhënë kontributin tonë në këtë drejtim.

"Epoka e re": Në fakt, ju si asociacion a do të kërkonti të jeni pjesë e grupit për hartimin e statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe?

Gashi: Ne si asociacion sapo e kemi zgjedhur kryesinë e re dhe natyrisht se presim informata të mëtutjeshme në këtë drejtim. Po e përsëris se si asociacion jemi të gatshëm ta japim kontributin tonë aty ku është i nevojshëm dhe i domosdoshëm.

"Epoka e re": Pra kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës është që asociacioni i ri serb të jetë pa kompetenca ekzekutive?

Gashi: Natyrisht. Asociacioni i

Komunave me Shumicë Serbe nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive. Duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mendoj se kjo është rruga e duhur dhe më e mira për krijimin e këtij asociacioni.

"Epoka e re": Mirëpo Serbia dhe përfaqësuesit politikë të serbëve të Kosovës kanë kërkuar që ky asociacion të ketë kompetenca më shumë sesa asociacioni ekzistues?

Gashi: Besoj se kjo nuk do të ndodhë, sepse një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës. Me siguri i keni dëgjuar edhe deklaratimet e Qeverisë së Kosovës, se një gjë e tillë nuk do të ndodhë dhe se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të themelohet vetëm sipas Kushtetutës së Kosovës.

"Epoka e re": Besoni se edhe ai asociacion duhet jetë një lloj OJQ-je sikurse ky aktual?

Gashi: Realisht ashtu duhet të jetë. Faktikisht nuk ka pasur nevojë fare të bëhet edhe një

asociacion tjetër në Kosovë sepse mjaftueshëm i përfaqëson interesat e të gjitha komunave asociacioni aktual i komunave. Mirëpo, siç e dini, ai asociacion është paraparë me Pakon e Ahtisarit, pastaj me marrëveshjen e Brukselit. Ajo që është më kryesorja, të gjithë thonë se ai asociacion duhet të jetë në harmoni me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës.

"Epoka e re": Krijimi i një asociacioni etnik mund të provokojë ndonjë ndarje të re në mes të komunave në Kosovë?

Gashi: Nëse ky asociacion themelohet sipas ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk besoj se mund të prodhojë diçka të tillë.

"Epoka e re": Pas themelimit të asociacionit të ri, si duhet të jetë raporti në mes të dy asociacioneve?

Gashi: Ne jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe gjithëherë këto bashkëpunime duhet të jenë vetëm në suaza të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës.

LDK-ja fton partitë politike për caktimin e datës për zgjedhje të reja

PRISHTINE, 3 PRILL (ER) - Kryesia e Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK) ka vlerësuar se vendi ka hyrë në krizë të thellë institucionale dhe politike. Kjo parti ka theksuar se Qeveria Haradinaj nuk e ka shumicën në Kuvendin e Kosovës dhe si e tillë konsiderohet e rënë. "Temat e rëndësishme për qytetarët e

vendit nuk mund të adresohen nga një qeveri e pakicës. Si rezultat, zgjedhjet e parakohshme janë të domosdoshme. LDK-ja fton që partitë politike të mblidhen sa më parë për ta caktuar datën e zgjedhjeve, në mënyrë që këto zgjedhje të jenë të përgatitura si duhet dhe vullneti i qytetarëve

të shprehet lirshëm. LDK-ja është e gatshme t'i nënshtrohet vullnetit të lirë të qytetarëve në zgjedhjet e pritshme", ka njoftuar LDK-ja pas mbledhjes së kryesisë. Kryesia e LDK-së i ka ftuar të gjitha strukturat e veta, në të gjitha nivelet, që të mobilizohen dhe t'i shtojnë përgatitjet e nevojshme për zgjedhje.



Është mbajtur dëgjim publik për Projektligjin për inovacion, shkencë dhe transferim të dijes dhe teknologjisë

Bytyqi: Me Projektligjin për inovacion përfitojnë të rinjtë

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, gjatë dëgjimit publik për Projektligjin për inovacion, shkencë dhe transferim të dijes dhe teknologjisë, ka theksuar se me këtë projektligj do të përfitojnë të rinjtë duke aplikuar me projekte të ndryshme

EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINE, 3 PRILL - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të martën në dëgjimin publik për Projektligjin për inovacion, shkencë dhe transferim të dijes dhe teknologjisë, ku para deputetëve të Komisionit Parlamentar për Arsim, institucioneve shkencore të Kosovës dhe institucioneve të tjera që merren me këtë fushë, ka folur për përmbajtjen e këtij projektligji.

Ministri Bytyqi ka theksuar rëndësinë e madhe që ka Projektligji për MASHT-in dhe për institucionet e tjera, puna e të cilave ndërlihet me këtë projektligj, ndërsa ka pohuar se debate të tilla do të shërbejnë që projektligji të pasurohet dhe të jetë më funksional. "Në bazë të këtij projektligji, shihet se secilit institucion të arsimit të lartë në veçanti, edhe ministrive të tjera dhe institucioneve, i është dhënë një peshë e veçantë dhe tani në mënyrë institucionale mund të organizohen për

zbatimin e projektligjit në momentin kur do të bëhet ligj, por edhe në forma të reja që ne do t'i qasemi në pjesën e inovacionit, teknologjisë dhe transferimit të dijes", është shprehur ministri Bytyqi.

Ai ka shtuar se si bartës kryesor të inovacionit në këtë projektligj është përcaktuar Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, institucionet kërkimore-shkencore, qendrat e inovacioneve, kompanitë dhe ndërmarrjet, personat e tjerë fizikë dhe juridikë vendorë dhe të huaj dhe institucionet e arsimit parauniversitar. "MASHT-i në pritje të aprovimit të këtij ligji është duke marrë masa të tjera. Ne jemi në një fazë ku Ministria tanimë është bashkëthemeluese e institucionit hulumtues me vendet e tjera të Evropës Juglindore. Tani u jepet mundësi institucioneve tona që të mund ta japin kontributin shkencor, si dhe të përfitojnë të rinjtë tanë dhe institucionet e ndryshme, duke u bazuar në këtë ligj, që të kenë mundësi të aplikojnë me



projekte të ndryshme", ka thënë ministri Bytyqi.

Duke folur për kompetencat, ministri Bytyqi ka sqaruar se MASHT-i menaxhon inovacionin shkencor dhe jo produktin e prekshëm, i cili mund t'i takojë Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Në vazhdim të debatit fjalën e mori këshilltarja e Ministrisë për Inovacion dhe Ndërmarrësi, Vanesa Rexhepi, e cila ka thënë se ky projektligj e qartëson bashkëpunimin dhe përgjegjësitë që bien në fushëveprimtarinë e MASHT-it

dhe të Ministrisë së Inovacionit. Ajo ka bërë me dije se do të ketë projekte të shumta në ndërtimin e shumë objekteve, si dhe ofrimin e mundësive të shumta për studentë dhe praktikantë, për t'u inkuadruar në këtë fazë të re, me ide dhe inovacione.

Arianit Zabërxha, përfaqësues i kompanisë "Formon", ka theksuar nevojën e fokusimit tek procesi i produktit, i cili, sipas tij, drejtpërdrejt lidhet me nenin 4, që ka të bëjë me bartësit e inovacionit shkencorë. Në këtë nen, sipas tij, mungon laboratorit para fabrikuesit i cili, siç ka theksuar ai,

do të duhej të ishte në fakultetet publike.

Po ashtu, Zabërxha ka kërkuar të ndryshohet edhe neni 6 i projektligjit.

Ndërsa përfaqësuesi i AVUK-ut austriak, Aqim Emurli, ka thënë se ky projektligj është i mirëpritur, duke e vlerësuar atë të një rëndësie të madhe. Përfaqësuesi i Institutit Albanologjik, Hysen Matoshi, vuri në pah nenin 4 lidhur me bartësit e inovacionit shkencor dhe ka propozuar që universitetet që kanë potencial, të jenë bartësit kryesorë, në mënyrë që të ketë rezultate më të mëdha.

Braathu: UP-ja, institucioni kyç për ndryshime pozitive në Kosovë

PRISHTINE, 3 PRILL (ER) - Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Marjan Dema, ka pritur të martën në takim shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin Jan Braathu. Në këtë takim e pranishme ishte edhe prorektorja për buxhet dhe financa në UP, Myrvete Badivuku-Pantina, si dhe shefi i seksionit të medieve nga Departamenti i Demokratizimit në OSBE, Dane Koruga.

Rektori Dema gjatë këtij takimi e ka njoftuar ambasadorin Braathu me zhvillimet në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me misionin dhe vizionin e këtij institucioni. Po gjatë këtij takimi u diskutua për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit në mes të UP-së dhe misionit të OSBE-së në Kosovë. "Për rreth dy vjet kemi arritur të implementojmë standarde të cilat mundësojnë qasje të barabartë për të gjithë, në të

gjitha aspektet e funksionimit të Universitetit të Prishtinës. Njëherësh kemi hapur disa qendra dhe zyra të reja, i kemi rifunksionalizuar shumë sosh të themeluara më parë, të gjitha në kuadër të rrugëtimit tonë drejt sigurimit të një ambienti sa më cilësor të mësimdhënies dhe mësimnxënies në Universitetin tonë", ka thënë Dema.

Ndërsa ambasadori Braathu ka theksuar se ndihet shumë i lumtur që sot gjendet në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Ai e ka përgëzuar rektorin Dema për ndryshimet e bëra në UP, të cilat, sipas tij, nuk është e lehtë t'i realizosh. "Universiteti i Prishtinës është institucioni kyç nga i cili mund të lindin ndryshimet pozitive në Kosovë. UP-ja është institucion jashtëzakonisht i rëndësishëm për vendin", ka potencuar Braathu. Në këtë takim, theks i



veçantë iu kushtua mundësive të bashkëpunimit në mes të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe misionit të

Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë, ku palët u pajtuan për realizimin e disa projekteve që

parashihnin ligjërata të përbashkëta për studentët e UP-së, kryesisht në fushën e medias dhe të ligjit.

Aleanca Kosova e Re (AKR) respekton vendimin e kryeministrit për lirim nga detyra e ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj

AKR-ja pajtohet për largimin e Sefajt nga posti i ministrit

Flamur Sefaj i është përgjigjur kryeministrit Ramush Haradinaj duke dhënë dorëheqje nga pozita e ministrit të Punëve të Brendshme, pas arrestimit dhe deportimit të gjashtë shtetasve turq në Turqi. Aleanca Kosova e Re (AKR) ka bërë me dije se Sefaj nuk ka qenë faktor vendimmarrës dhe vetëm ka zbatuar ligjin përkitazi me kërkesën e AKI-së, institucion ky i cili, sipas Kushtetutës, ka vlerësuar se gjashtë shtetasit turq kanë përbërë rrezik për sigurinë kombëtare të Kosovës

EPOKA E RE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 3 PRILL - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Flamur Sefaj, i cili vjen nga radhët e Aleancës Kosova e Re (AKR), ka dhënë zyrtarisht të martën dorëheqje nga ky post pas kërkesës së kryeministrit Ramush Haradinaj për lirin nga detyra. Në letrën e dorëheqjes, ministri Sefaj e ka informuar kryeministrin e Kosovës lidhur me procesin e deportimit të shtetasve turq dhe përfshirjen e

tij në zbatim të ligjit në atë proces. AKR-ja përmes një komunikate për medie ka bërë me dije se Sefaj nuk ka qenë faktor vendimmarrës dhe vetëm ka zbatuar ligjin përkitazi me kërkesën e AKI-së, institucion ky i cili, sipas Kushtetutës, ka vlerësuar se personat e lartcekur përbëjnë rrezik për sigurinë nacionale të Republikës së Kosovës. "Sa i përket informimit të kryeministrit për këtë proces, AKI-ja obligohet me ligj që t'i raportojë në të njëjtën kohë kryeministrit, prandaj duhet të



sqarohet nëse kjo ka ndodhur apo jo. Ministri Sefaj nuk ka qenë fare në dijeni se cka përfaqësojnë ata persona, por

vetëm ka zbatuar ligjin i cili aktivizohet në rastet kur AKI-ja vlerëson se po cenohet siguria shtetërore e Kosovës", është

thënë në komunikatën e AKR-së. AKR-ja në këtë komunikatë ka vlerësuar jashtëzakonisht lart punën dhe angazhimin e Sefajt në zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. "Ministri Sefaj në vazhdimësi ishte i vendosur për mbrojtje të Republikës dhe Kushtetutës së vendit, sikur në rastin e ndalimit të Marko Gjuriq, i cili hyri jashtëligjshëm në territorin e Kosovës si dhe në shumë detyra të tjera, në mënyrë institucionale e dinjitoze, me përgjegjësi e respekt ndaj shtetit, në rend të parë", është theksuar në komunikatën e AKR-së.

Kryeministri Haradinaj ditë më parë i liroi nga detyra ministrin e MPB-së, Flamur Sefaj dhe drejtorin e AKI-së, Driton Gashin. Për dallim nga Sefaj që tashmë ka pranuar lirin nga detyra, një gjë të tillë nuk e ka bërë Driton Gashi. Për shkarkimin e këtij të fundit duhet të japë pajtimin edhe presidenti Hashim Thaçi.

Arrestohen tre persona, konfiskohen armë, drogë, automjete dhe para

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) -

Policia e Kosovës gjatë një aksioni antidrogë ka arrestuar tre persona dhe ka konfiskuar armë, municione, drogë, telefona, automjete, pajisje të ndryshme si dhe para. Ky aksion ka ndodhur në fshatin Miradi e Epërme në Fushë-Kosovë. "Në përpjekjet e vazhdueshme të Policisë së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e dukurive negative, në veçanti luftimin e trafikimit të narkotikëve, më 29. 3. 2018, gjatë implementimit të planit operativ 'Stop drogave nëpër shkolla', njësitet e antidrogës së PK-së, në bashkëpunim me prokurorinë kompetente, pas ndërmarrjes së një sërë veprimesh hetimore dhe operacionale, në fshatin Miradi e Epërme në Fushë-Kosovë kanë arrestuar tre persona të dyshuar: B. L., A. G. dhe A. G.) të përfshirë në veprat penale 'blerje, posedim, shitje ose shpërndarje e paautorizuar e substancave narkotike' dhe 'mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve'", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës. Po nga personat e dyshuar janë



konfiskuar dy vetura, katër telefona celularë dhe 690 euro para të gatshme. "Bazuar në hetimet e realizuara, prejardhja e substancës narkotike ishte nga Republika e Shqipërisë dhe për destinacion kishte Prishtinën", është thënë në këtë njoftim. Policia ka bërë me dije se me aktvendim të prokurorit kompetent të dyshuarit janë dërguar në qendrën e mbajtjes, kurse rasti i mbetet në kompetencë Njësitit Antidrogë të Prishtinës për hetim të mëtejshëm. "Policia e Kosovës mbetet fuqishëm e përkushtuar për luftimin e trafikimit të substancave narkotike dhe rikonfirmon se masa rigoroze do të zbatohen ndaj të gjithë personave të dyshuar të përfshirë në veprime të tilla të kundërligjshme", është theksuar në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Agim Veliu zgjedhet kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 PRILL - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka mbajtur të martën Kuvendin e Përgjithshëm vjetor në të cilin kanë marrë pjesë delegatët nga komunat e Republikës së Kosovës dhe kryetarët e komunave. Në këtë Kuvend janë zgjedhur edhe organet e reja drejtuese.

Kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, është zgjedhur kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, kurse zëvendëskryetar është zgjedhur kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi. Po ashtu, Kuvendi

zgjodhi edhe anëtarët e Bordit të AKK-së: Haki Rugova (kryetar i Komunës së Istogut), Imri Ahmeti (kryetar i Komunës së Lipjanit), Agron Kuçi (kryetar i Komunës së Junikut), Agim Aliu (kryetar i Komunës së Ferizajt) dhe Dragan Petkoviç (kryetar i Komunës së Parteshit).

Me këtë rast, kryetari i porsazgjedhur i AKK-së, Agim Veliu, ka falënderuar delegatët e Kuvendit për besimin e dhënë. "Siç e dini, Asociacioni i Komunave të Kosovës është një organizatë tërësisht e komunave të Kosovës dhe është në shërbim të plotë të pushtetit lokal dhe sfidave e çështjeve që preokupohet ky nivel i qeveris-

jes në Republikën e Kosovës. Si ka qenë deri më tani, AKK-ja edhe në mandatin tim si kryetar i tij do të jetë një organizatë jopolitike e jopartiake, por një organizatë e cila punon dhe angazhohet vetëm në drejtim të mbrojtjes së interesave të komunave të Kosovës. Angazhimi i deritashëm në këtë drejtim ka sjellë këtë imazh dhe reputacion që ka Asociacioni i Komunave të Kosovës si te niveli qendror, po ashtu edhe te komuniteti i donatorëve", ka thënë Veliu.

Para zgjedhjes së kryetarit të ri të AKK-së këtë institucion e ka drejtuar kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli.



Nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar mbi 26 mijë familje

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 26 117 familje, me gjithsej 106 628 anëtarë. Kurse nga skema për mbështetje materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme kanë përfituar 2 761 familje

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 3 PRILL - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e Mirëqenies Sociale" për vitin 2017. Ky publikim ofron të dhëna për numrin e përfituesve nga skema e ndihmës sociale, skema e pensioneve bazike të moshës, pensioneve kontributpaguese të moshës, pensioneve për personat me aftësi të kufizuara, skemën për mbështetje materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, skemën e pensioneve për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe

veteranëve të luftës, skemën e pensioneve të Trepçës, skemën e pensioneve për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, skemën e kompensimeve për personat e verbër etj.

Sipas rezultateve të dalura nga ky publikim, del se nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 26 117 familje me gjithsej 106 628 anëtarë, kurse nga skema për mbështetje materiale familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme kanë përfituar 2 761 familje. Ndërsa nga skemat pensionale janë 122 716 përfitues me pensione bazike të moshës; 43 300 përfitues me



pensione kontributpaguese të moshës; 19 481 përfitues me pensione për personat me aftësi të kufizuara; 12 472 përfitues me pensione për familjet e dësh-

morëve dhe invalidët e luftës; 36 032 përfitues me pensione për veteranët e luftës; 3 232 përfitues me pensione të Trepçës; 1 001 përfitues me pensione të

Trupave Mbrojtëse të Kosovës; 288 përfitues me pensione për Forcat e Sigurisë së Kosovës; dhe 2 001 përfitues me kompensime për personat e verbër.

Bilanci tregtar Kosovë - Shqipëri, 1 me 5

PRISHTINË, 4 PRILL - Kryetari i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, ka thënë se ideja e tregut të përbashkët ndërmjet vendeve të Ballkanit do të ishte e mirëseardhur, pasi Kosova dhe Shqipëria nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën. Këto komente Zeka i ka bërë të martën në tryezën "Tregtia me Shqipërinë: sa komplekse" që është organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Zeka ka thënë se barrierat ndërmjet dy vendeve nuk kanë kuptim. "Barrierat ndërmjet dy vendeve nuk kanë kuptim sepse Kosova e Shqipëria nuk konkurrojnë mes vete. Kjo temë vazhdon të jetë më e diskutuara pavarësisht prej takimeve në rrafshin politik, ndërsa në praktikë mbetet për t'u



bërë më shumë. Ideja për të pasur një treg të përbashkët mes vendeve të Ballkanit do të ishte

ide e mirë. Ne nuk i konkurrojmë njëra-tjetrës, Kosovës dhe Shqipërisë", ka thënë Zeka.

Ndërsa kryetari i Bordit të Odës Ekonomike Amerikane, Ilir Ibrahim, ka thënë se ka një përp-

jekje nga dy qeveritë shqiptare për heqjen e barrierave tregtare mirëpo, sipas tij, një gjë e tillë nuk është duke ndodhur ende. "Një integrim ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë mund të ndodhë vetëm atëherë kur bizneset e të dyja vendeve ndihen të barabartë", ka thënë Ibrahim. Ai ka ngritur si shqetësim edhe taksën rrugore në Rrugën e Kombit që, sipas tij, është një prej barrierave shtesë për bizneset e Kosovës.

Më tutje, Mërgim Prishtina nga "Trepsharm" ka thënë kërkuar që most'u hidhet hi syve ndaj bizneseve me mbledhjet e dy qeverive shqiptare. Sipas tij, problemet në Shqipëri janë të të bërit biznes, kurse bilanci tregtar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është 1 me 5 në favor të Shqipërisë.

'Finnesa' dhuron shpërblimin prej 10 mijë eurosh

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Shkurte Berisha është fituese e premisë kryesore prej 10 000 eurosh në lojën "Hap dhe fito" të organizuar nga kompania e miellit "Finnesa". Shpërblimi është dhuruar më 26 mars të këtij viti. "Jam konsumatore e rregullt e miellit 'Finnesa'. Ka qenë ditë e diel kur e kam hapur paketimin për të gatuar krepa në të cilin më ka qëlluar kuponin i 10 000 eurove. Prej gëzimit të madh kam vazhduar t'i gatuar

krepat të cilët dolën edhe më të shijshëm. Nuk kam menduar ende ku t'i shpenzoj të hollat, mirëpo ide kam shumë", ka thënë ajo.

Mielli "Finnesa" vazhdon t'i shpërblejë konsumatorët me lojën e re shpërblyese "Hap dhe fito", ku premia e ardhshme në lojën e re shpërblyese është vetura "FIAT 500" dhe shpërblimet e tjera më të shpeshta janë prej 10, 20, 50, 100 deri në 500 euro.



Amerikanët të interesuar për projekte të riciklimit dhe energjisë në Kosovë

Drejtori i kompanisë "Ekobase Global" për Evropë, Tomaz Groff, gjatë takimit me ministrin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka theksuar se si kompani janë duke i shikuar mundësitë të investojnë në fushën e energjisë së ripërtërishme

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 PRILL - Përfaqësues të kompanisë "Ekobase Global" janë pritur të martën në një takim nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, nga i cili janë njoftuar me planet për projekte konkrete në fushën e riciklimit të gomave të vjetra dhe energjisë së ripërtërishme.

Ministri Gashi ka informuar përfaqësuesit e kësaj kompanie lidhur me mundësitë të cilat ofrohen sipas Ligjit për Investime Strategjike. "Momentalisht konsiderohemi

shteti më liberal për sa iu përket mundësive të cilat ua ofrojmë investitorëve që potencialisht kualifikohen si investitorë strategjikë në fushën e minierave, energjisë dhe turizmit. Deri tani kemi marrë aplikacionin e parë në fushën e energjisë solare nga një kompani shqiptarogjermane, ndërsa presim së paku edhe katër aplikacione në fushën e minierave", ka thënë ministri Gashi.

Të dyja palët u morën vesh që në vizitën e ardhshme në Kosovë të diskutohen edhe modalitetet konkrete të projektit në fjalë.

"Ekobase Global Inc" është kompani nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me degë



në disa shtete të Bashkimit Evropian. "Ekobase Global Inc" është duke implementuar projekte të ngjashme edhe në Slloveni dhe Spanjë.

Drejtori i kësaj kompanie për Evropë, Tomaz Groff, ka thënë se kanë shprehur interesim ta përfshijnë edhe Kosovën në këtë iniciativë që është duke marrë

përmasa globale. Ai ka bërë me dije se në Kosovë kanë ardhur për të shikuar edhe mundësi të tjera të investimit në fushën e energjisë së ripërtërishme.

Nxënësit e shkollave të mesme njoftohen me rolin e ATK-së



PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka mbajtur seminar me nxënësit e shkollave të mesme nëpër komuna për t'i njoftuar ata për rolin e ATK-së në mbledhjen e të hyrave për buxhetin e Republikës së Kosovës, si dhe për

rëndësinë e tatimeve në zhvillimin e përgjithshëm të shtetit. Lidhur me rolin dhe rëndësinë e tatimeve, ATK-ja ka përgatitur materialin në formë vizuale, ku gjatë prezantimit u shpjegohet nxënësve se përmbushja e obligimeve tatimore nga qytetarët e

Kosovës në mënyrë të drejtpërdrejtë krijon parakushte më të mira për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve në të gjitha fushat e jetës.

Nxënësit gjatë këtij seminari kanë pasur mundësinë t'i ndjekin spotet mediale të ATK-së

për rolin dhe funksionin që luan kuponin fiskal. Po ashtu, nxënësit gjatë këtij prezantimi me interesim të veçantë u parashtruan pyetje të shumta zyrtarëve të ATK-së lidhur me tatimet.

Deri më tani seminarët me nxënësit maturantë janë mbajtur

në 12 shkolla të mesme, në komunat si ajo e Prishtinës, e Podujevës, e Fushë-Kosovës, e Drenasit, e Lipjanit dhe e Obiliqit. Seminari do të vazhdojë edhe me nxënësit nga klasa e pestë në komunat e lartpërmendura.

Ilir Shala zgjedhet kryeshf ekzekutiv i KOSTT-it

PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Në takimin e mbajtur më 1 mars, Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, pas një procedure të hapur dhe konkurruese, ka marrë vendim

ta emërojë Ilir Shalën, kryeshf ekzekutiv të KOSTT-it. Për pozitën e kryeshf ekzekutiv kanë aplikuar 11 kandidatë, 4 prej të cilëve kanë qenë në

listën e ngushtë. Ilir Shala është magjistër në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në Universitetin e Prishtinës si dhe magjistër për Menaxhim të

Shërbimeve dhe Lidershitit nga Rochester Institute of Technology (RIT Kosovë). Shala ka një përvojë mbi 18-vjeçare në sektorin e energjisë.



Malisheva kërkon sa më shpejt realizim të projekteve komunale

MALISHEVË, 3 PRILL (ER) - Komuna e Malishevës ka filluar punimet në disa nga projektet që kanë qenë të planifikuara të nisin këtë vit. Kështu është bërë me dije në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të cilën e ka drejtuar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili në të njëjtën kohë ka kërkuar të mos ketë vonesa për realizimin e projekteve dhe planifikimeve komunale për vitin 2018. "Të gjitha projektet të realizohen, duke u bazuar në planin dinamik të realizimit të projekteve dhe të mos ketë vonesa të paarsyeshme për realizimin e tyre", ka thënë nënkryetari Berisha, duke iu drejtuar drejtorëve të drejtorive komunale. Gjithashtu, punimet kanë filluar edhe në disa projekte të bartura nga viti i kaluar. Në këtë mbledhje u raportua edhe për punët dhe aktivitetet për javën e kaluar dhe planifikimet për javën në vijim nga të gjitha drejtoritë. Në këtë mbledhje nga drejtoritë



përgjegjëse u shpreh edhe një herë shqetësimi për vonesën e shkaktuar nga niveli qendror për realizimin e fushatës

së repelimit të kafshëve, si masë parandaluese për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo.

Për 24 orë mbi 1 000 gjoba pjesëmarrësve në trafik



PRISHTINË, 3 PRILL (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit ka shqiptuar gjithsej 1 256 gjoba për pjesëmarrësit në trafik. Nga 28 aksidente që kanë ndodhur, 9 prej tyre kanë përfunduar me të lënduar, kurse

19 pa të lënduar. Sipas të dhënave të raportit policor, dy persona janë dërguar në vuajtje të dënimit, 7 të tjerë në mbajtje, kurse kanë ndodhur 17 arrestime në 24 orët e kaluara në Kosovë.

Komuna e Skenderajt shpërndan 1 000 kontejnerë të mbeturinave

SKENDERAJ, 3 PRILL (ER) - Komuna e Skenderajt është në fazën e parë të implementimit të planit komunal për menaxhimin e mbeturinave. Një ndër objektivat e këtij plani është edhe zgjerimi i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, ku Komuna e Skenderajt ka investuar për blerjen e një sasi të kontejnerëve për mbeturinën të tipit 120 litërsh.

Komuna e Skenderajt ka shpërndarë një sasi rreth 1 000 kontejnerë të mbeturinave të tipit 120 litra. Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se kontejnerët janë shpërndarë në disa pjesë të qytetit dhe disa fshatra sipas prioritetëve që janë përcaktuar në planin komunal dhe sipas klientëve që janë në shërbim. "Kjo sasi e kontejnerëve nuk është e mjaftueshme për t'i përmbytur të gjitha kërkesat e qytetarëve mirëpo, bazuar në memorandumun e bashkëpunimit në mes të Komunës së Skenderajt dhe GIZ-it gjerman, së bashku do ta shqyrtojmë mundësinë që edhe në të ardhmen të investohet në blerjen e kontejnerëve dhe ngritjen e kapaciteteve për menaxhim sa më të mirë të mbeturinave", ka thënë ai. Jashari ka thënë se, pavarësisht prej kërkesave dhe gatishmërisë së qytetarëve për të hyrë në shërbim, sfida mbeten



kapacitetet e kompanisë "Uniteti" - njësia në Skenderaj - për të ofruar shërbim cilësor. "Komuna e Skenderajt në të ardhmen do t'i ngrëhë kapacitetet për menaxhim të

mbeturinave. E gjitha kjo punë që është duke u realizuar është për ngritjen e vetëdijesimit për një mjedis sa më të pastër", ka thënë Bekim Jashari.

RAPORTI POLICOR



Me maska kërcënojnë gruan në oborrin e saj

DEÇAN, 3 PRILL - Një grua nga fshati Strellc i Ulët i Deçanit ka njoftuar policinë se derisa ishte në oborrin e shtëpisë së saj, dy persona të panjohur dhe të maskuar i kanë kërkuar para dhe e kanë kërcënuar. Siç njofton policia, të dyshuarit nuk kanë arritur ta realizojnë qëllimin, duke u larguar në drejtim të panjohur. Rasti është duke u hetuar.

Aksident në Lipjan, vdes këmbësori

Lipjan, 3 prill - Një fatkeqësi në trafik, me pasojë vdekjen e njeriut, ka ndodhur të martën në fshatin Ribadh i Madh në Komunën e Lipjanit. Sipas policisë, një 59-vjeçar është goditur nga një veturë. Si pasojë e plagëve të marra, viktimë ka ndërruar jetë në QKUK. Njësia policore e trafikut rajonal ka dalë në vendin e ngjarjes për t'i bërë ekzaminimet e duhura si dhe po ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për sqarimin e rrethanave që kanë sjellë deri tek aksidenti.

Një serb sulmon të miturin boshnjak në Mitrovicë

MITROVICË, 3 PRILL - Një djalë i moshës së mitur i komunitetit boshnjak ka raportuar se në rrugën "Nemanjina" në Mitrovicë është sulmuar fizikisht nga një serb. Viktima ka marrë tretman mjekësor në Qendrën Mjekësore Familjare të këtij qyteti, ndërsa i dyshuari, pas intervistimit, është liruar me vendim të prokurorit. Policia e Kosovës ka njoftuar se rasti është duke u hetuar.

Tre persona sulmojnë një të afërm

MALISHEVË, 3 PRILL - Tre persona në Malishevë janë arrestuar si të dyshuar, të cilët, pas një mosmar-rëveshjeje familjare, kanë sulmuar fizikisht një person. Viktima ka pësuar lëndim trupor, ku fillimisht trajtimin e ka marrë në QKMF-Malishevë, më pas është dërguar për tretman mjekësor në QKUK. Policia e Kosovës ka njoftuar se me vendim të prokurorit tre të dyshuarit janë dërguar në qendrën e mbajtjes.

(Sulmeve të jashtme t'u përgjigjemi me mobilizim të brendshëm)

PADIJA DHE GRYKESIA JANË KRYEPROBLEMET TONA



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Duhet të jemi të vetëdijshëm, Kosova e pavarur, sovranë e demokratike i ka armiqtë e saj qoftë të drejtpërdrejtë, qoftë të tërthortë, për faktin se shtetin e kemi bërë në shekullin XXI. Prandaj, ne, shqiptarët (apo politika jonë) nuk duhet të merremi me ta, pasi nuk na janë të panjohur. Problemet tona më shumë janë të brendshme dhe nëse ka deklarime të jashtme të pafavorshme deri në armiqtë, burimi i atyre deklaratave janë brenda vendit. Është padija e më shumë mosgatishmëria jonë për të organizuar, ndërtuar dhe përparuar shtetin si duhet dhe me njerëz të duhur. Është mosgatishmëria jonë politike për t'i respektuar rendin dhe

ligjin. Është lakmia e njerëzve tanë të luftës e të "paqes" për ta përdorur pushtetin për interesa individuale e grupore. Është grykësia e njerëzve tanë të luftës e të "paqes" për ta grabitur pasurinë kombëtare e publike. Është nepotizmi ynë për t'i vendosur në pozita të rëndësishme të shtetit njerëzit tanë të padijshëm e të dëgjueshëm. Është gatishmëria e të parit të shtetit për t'i kapur të gjitha segmentet vitale të shtetit dhe për t'i bërë ato jofunksionale. Është gatishmëria e njerëzve të vendosur pa ndonjë meritë në institucionet e sigurisë, pastaj gatishmëria e tyre për t'ju shitur drejt e të birit, siç thuhet rëndomë. Është gatishmëria e njerëzve të politikës, ose të afërmeve të tyre, për t'u lidhur për interesa tregtie me kriminelët e Veriut dhe kriminelët e tjerë jashtë vendit, të cilët, po të mundnin, do ta zhbënin shtetin tonë. Është mosgatishmëria jonë për ta ndërtuar shtetin e së drejtës. Ishte mosgatishmëria e

kryeqeveritarëve të deritashëm për të mos krijuar hapësirë ligjore investitorëve të jashtëm e, besa, as atyre të brendshëm. Është mosgatishmëria e deritashme e politikës për të ndërtuar një arsim të planifikuar për zhvillimin e vendit. Është mosgatishmëria e njerëzve të instaluar në shëndetësinë publike për ta ndërtuar sistemin e duhur të shëndetit publik e për të mos i derdhur milionat jashtë shtetit. Është mosgatishmëria e njerëzve që kanë qeverisur vendin deri më tani për të ndërtuar një shoqëri të së drejtës sociale, përkundrazi, janë mbjellësit e mjerimit... Që njerëzve të mjerë t'ua blejnë votat! Është gatishmëria e drejtuesve të institucioneve vitale të vendit për të shkelur ligjet në fuqi dhe Kushtetutën për interesa personale e në dëm të vendit. Prandaj nuk kemi pse të hyjmë në polemika me ata që njerëzit tanë ua mundësojnë ndërhyrjet e tyre në Kosovë,

për interesa krejt personale të të parit të shtetit. Që shtatë vjet bisedohet me Serbinë për punët tona të brendshme, pa asnjë kushtëzim të vetëm. Ndërsa Serbia më se një herë ka ushtruar gjenocid mbi popullin tonë! Edhe sot me ata që po bisedohet gju me gju dhe në distancë, shtetin tonë e quajnë: "terrorist e banditesk" dhe kush po e thotë? Po e thotë njeriu që para pak viteve deklaronte: "Për një serb të vrarë ne do t'i vrasim njëqind boshnjakë", as për shqiptarët e kroatët nuk mendonte ndryshe. E dhimbjet njerëzore të shkaktuara nga politikat e gjenocidit serb, të parët e shtetit i kujtojnë vetëm në "Facebook", por, jo atje ku duhet dhe është dashur. Politika jonë, duhet ta ndërtojë pa hezituar shtetin e së drejtës, shtetin ku sundon rendi e ligji e jo Maliqi. Shtetin që investon për siguri e zhvillim e jo për krim e korrupsion. Nëse politika shqiptare, aty ku është e ulur në karrigen e pushtetit,

punon pa hile për kombin e shtetin, për sigurinë kombëtare e progresin shoqëror, s'ka pse i dëgjon dërdëllitjet nga Beogradi dhe miqtë e tyre. Beogradi për gati 100 vjet nuk ka dashur të dëgjojë e të bisedojë, çka mund të presim tani nga krijesat e politikës që ka ushtruar gjenocid mbi popullin tonë? Të gjitha vitet e bisedimeve të Brukselit po e konfirmojnë kotësinë e dialogut Kosovë-Serbi. Kërcënimeve të Serbisë, se "ketë muaj do ta bëjnë Zajednicën", duhet t'ju përgjigjemi meritueshëm. Ata le të krijojnë Zajednica në Serbi. Për Kosovën vendosim ne dhe ne e kemi asociacionin e komunave, ai, statuti i tij, duhet të vlej edhe për komunat me shumicë serbe. Kur politikanet tanë, përgjegjësit e politikës kombëtare, t'i kryejnë detyrat e tyre në shërbim të kombit e të shtetit, deklaratat e të tjerëve, ngado që do të vijnë, do ta kenë efektin e "borës së parvjetme"!



Mujka: Investimet e KEDS-it, të rëndësishme për Mitrovicën

MITROVICE, 3 PRILL (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, i shoqëruar edhe nga drejtori i Infrastrukturës, Naser Muja, drejtori i Urbanizmit, Sami Zeka, si dhe drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, kanë zhvilluar të martën një takim me drejtues të KEDS-it.

Në këtë takim temë diskutimi kanë qenë investimet e reja që pritet të bëhen gjatë vitit 2018 të KEDS-it në qytetin e Mitrovicës. Po në këtë takim është biseduar edhe për dislokimin e trafave elektrike për disa fshatra të qytetit të Mitrovicës, por edhe për projektet e tjera ku do të lehtësohet jeta e qytetarëve. Me këtë rast, nënkryetari Mujka ka

falënderuar drejtuesit e KEDS-it duke thënë se investime të këtij lloji janë shumë të rëndësishme për qytetin e Mitrovicës në mënyrë që të kemi një gjendje stabile të energjisë elektrike. Në vitin 2017 nga KEDS-i janë investuar më shumë se 1.1 milion euro, ndërsa për vitin 2018 pritet të investohen afër 1.8 milion euro.

Syla bënë homazhe pranë lapidarit të Islam Kastratit

DRENAS, 3 PRILL (ER) - Me rastin e shënimit të 19-vjetorit të vrasjes së martirit nga fshati Nekoc, Islam Ramadan Kastrati, nënkryetari i Komunës së Drenasit, Gani Sylaj, ka bërë homazhe të lapidarit i këtij dëshmori në oborrin e shkollës së fshatit.

Me këtë rast, nënkryetari Sylaj ka thënë se vrasja e Islam Kastratit është dëshmia më e madhe se forcat serbe nuk kanë kursyer as nxënës të shkollave fillore. Homazhe pranë lapidarit të dëshmorit kanë bërë edhe nxënësit dhe banorët e fshatit Nekoc.




50 vjet nga vrasja e Martin Luter Kingut

Më 4 prill bëhen 50 vjet nga vrasja e Martin Luther Kingut, një udhëheqësi me mjaft ndikim, i cili, nëpërmjet një filozofie që kundërshtonte dhunën, mobilizoi miliona njerëz për t'i mbrojtur të drejtat civile në Amerikë

UASHINGTON, 3 PRILL - Më 4 prill bëhen 50 vjet nga vrasja e Martin Luther Kingut, njeriut që mobilizoi miliona njerëz për t'i mbrojtur të drejtat civile në Amerikë. Nëpërmjet një filozofie që kundërshtonte dhunën, Martin Luther Kingu ndihmoi që Shtetet e Bashkuara të miratonin dy ligje të rëndësishme të shekullit 20: Aktin për të Drejtat Civile të vitit 1964 dhe Aktin për të Drejtat e Votës një vit më vonë. Martin Luther Kingu ishte një udhëheqës me mjaft ndikim, por herë-herë hezitues i Lëvizjes Amerikane për të Drejtat Civile. Më 4 prill 1968 ai do të vritej në ballkonin e një moteli pranë qytetit Memphis të shtetit Tennessee. Njeriu i akuzuar për vrasjen ishte James Earl Ray, i cili më vonë u dënua me burgim. Më shumë se 100 mijë njerëz u rreshtuan në rrugët e Atlantës, vendlindja e Martin Luther Kingut, për t'ia dhënë lamtumirën e fundit. Funerali i tij mbledhi disa nga njerëzit më të njohur të Amerikës: senatorin Robert Kennedy; presidentin e ardhshëm Richard Nixon dhe aktivistin e të drejtave civile,

Jesse Jackson.

Xhekson u intervistua nga "Zëri i Amerikës" në gusht të vitit 2011 me rastin e përvënimit të një përmendoreje kushtuar Martin Luther Kingut në Uashington. "Ai ishte një simbol i fuqisë dhe drejtësisë, i paqes dhe pajtimit, por na u desh të fitojmë disa beteja të mëdha për ta arritur pajtimin. Beteja e Montgomerit, për shembull, ku pati edhe konfrontime", tha Jacksoni. Betejat në Alabama ishin për të drejtat e votimit që u mohoheshin afrikano-amerikanëve në shumë pjesë të jugut amerikan. Ato u pasuan nga dhuna policore në qytetin Selma, që hyri në histori si "E diela e përgjakshme". Kongresisti John Lewis ishte një nga udhëheqësit e protestave të studentëve. "Ata na u vërsulën duke na rrahur me shkopinje dhe duke na shkelur me kuaj. Unë u godita në kokë me kamxhik. Mendova se do të vdisja. Mu duk sikur pashë vdekjen", tha ai. Dhuna në televizion shkaktoi një protestë kombëtare. "Duhet që bota ta dijë se është e nevojshme të protestohet për



këtë të keqe të trefishtë; që nga mohimi i të drejtës për të votuar e deri te dhuna e egër policore", u shpreh Martin Luther King. Pak ditë më vonë, një urdhër i gjykatës i dha leje Martin Luther Kingut të udhëhiqte dhjetëra-mija demonstrues, për të marshuar nga Selma deri në Montgomeri, kryeqytet i Alabamës. John Lewis kujton këtë episod. "Martin Luther Kingu erdhi për të më vizituar në spital dhe tha: 'John, mos u shqetëso. Ne do ta bëjmë marshimin dhe Akti i të Drejtave të Votimit do të miratohet", tha ai. Një vit pasi presidenti Lyndon Johnson nënshkroi Ligjin mbi të Drejtat Civile, strategjia e Martin Luther Kingut për protesta paqësore çoi në nënshkrimin e

Aktit të të Drejtave të Votimit në vitin 1965. "Martin Luther Kingu besonte te procesi ligjor, por ai mendonte se ky proces ishte tepër i ngadalshëm, prandaj duhej demonstruar, duhej edhe procesi legjislativ. Ai besonte në veprimin masiv për të transformuar kulturën që ekzistonte në atë kohë", thotë Jesse Jackson. Më i famshmi ishte marshimi i marsit 1963 në Uashington. Rreth 250 mijë njerëz u mbledhën në lëndinën qendrore të kryeqytetit për ta dëgjuar fjalimin e Martin Luther Kingut. Ishte fjalim për ëndrrën e lirisë dhe të barazisë në një vend që u ndërtua mbi shpinat e skllëverve. Gazetari i "New York Times", Earl Caldwell, u dërgua në Memphis për t'i përcjellë aktivitetet e Martin Luther

Kingut. "Martin Luther Kingu më tha se do të mblidhte njerëz të varfër nga i gjithë vendi, do t'i sillte në Uashington dhe do ta ndalte punën e qeverisë derisa ajo ta trajtonte çështjen e varfërisë, veçanërisht mes afrikano-amerikanëve", tha Caldwell. Miratimi i Ligjit për të Drejtat Civile vërtet solli ndryshime ligjore në vitet 1960, por ndryshimi i vërtetë shpesh është i ngadaltë. "Ne sot jemi një vend i ndryshëm dhe më mirë në kuptimin që ligjet barbare të aparteidit racor kanë marrë fund, por ende ka një hendek ekonomik. Ne jemi të lirë, por më pak të barabartë", thotë Jesse Jackson.

Trashëgimia e Martin Luther Kingut si udhëheqës i protestës paqësore vazhdon. Kohët e fundit rreth 800 mijë njerëz u mbledhën në Uashington për të kërkuar kontrollë më të forta mbi armët e zjarrit. Mes tyre ishte edhe mbesa e Martin Luther Kingut, Yolanda. "Gjyshi im kishte një ëndërr që katër fëmijët e tij të vegjël nuk do të gjykohehin nga ngjyra e lëkurës, por nga karakteri", tha ajo. Para vrasjes në vitin 1968, Martin Luther Kingu iu dha Çmimi Nobel i Paqes për fushatën e tij të padhunshme për barazi. Sot më shumë se 100 shkolla dhe mbi 900 rrugë në ShBA mbajnë emrin e tij.

Erdogani pret Putinin në Ankara



ANKARA, 3 PRILL - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan dhe presidenti rus, Vladimir Putin, kanë prezantuar edhe zyrtarisht punimet për centralin e parë bërthamor të Turqisë. Projekti 20 miliardë dollarë po ndërtohet në rajonin jugor të Turqisë, Mersin. Erdogan dhe Putini janë takuar të martën në kryeqytetin turk, Ankara, dhe së bashku kanë shikuar ceremoninë e përvënimit të centralit përmes një video-konference në

pallatin presidencial në Ankara. Kanali televiziv shtetëror TRT ka shfaqur pamje të punëtorëve të cilët janë parë duke punuar tekta fishekzjarrë janë lëshuar në ceremoninë e 3 prillit. Punimet në rrugë dhe objekte të tjera të lidhura me projektin kanë nisur disa vite më parë. Ankara i ka siguruar korporatës shtetërore ruse të energjisë, lejen e punës për një nga katër njësitë në centralin bërthamor që gjendet më pak se një kilometër nga Deti Mesdhe.

Turqia pret që stacioni bërthamor të jetë funksional deri më 2023, mirëpo punimet në projekt janë penguar më parë. Vizita e Putinit në Turqi shënon udhëtimin e tij të parë prej kur ai ka fituar një tjetër mandat si president rus. Putini dhe Erdogani kanë diskutuar edhe për marrëdhëniet dypalëshe në tregti dhe bashkëpunimin ekonomik gjatë bisedimeve në Ankara. Në agjendën e tyre ka qenë edhe plani turk për të blerë sisteme raketore nga Rusia si dhe gjendja aktuale në Siri.

Prokurorët kërkojnë ekstradimin e ish-udhëheqësit katalanas Puigdemont

BERLIN, 3 PRILL - Prokurorët në Gjermani i kanë kërkuar një gjykatë rajonale që ta lejojë ekstradimin e ish-udhëheqësit separatist katalanas Carles Puigdemont, i cili përballet në Spanjë me akuzat për nxitje të kryengritjes, që lidhet me organizimin e referendumit për pavarësinë. Puigdemont fillimisht u largua pas votimit nga Spanja për në

Belgjikë, por më pas shkoi në Gjermani, ku që nga 25 marsi po mbahet i ndaluar. Agjencia franceze e lajmeve njoftoi se avokati i Puigdemont e ka apeluar vendimin e Gjykatës së Lartë të Spanjës për ndjekjen e tij ligjore, nën akuzat për nxitje të kryengritjes, duke cituar se veprimet e tij nuk lidheshin me dhunën pas referendumit.

Me akuzat për kryengritje përballet edhe 24 udhëheqës të tjerë separatistë katalanas. Ligjvënësit pro-pavarësisë fituan me një shumicë të vogël në zgjedhjet parlamentare të dhjetorit në Katalonia, por Parlamenti nuk ka mundur të emërojë një president të ri që nga koha kur Puigdemont u largua nga vendi dhe e ardhmja e pavarësisë nuk është e qartë.



(Me rastin e promovimit të librit "NATO Intervention in Kosova", të prof. dr. Nusret Pllana, në shenjë të 19-vjetorit intervenimit të NATO-s në Kosovë)

Mosharresa në shërbim të kujtesës historike

Prof. dr.
Sabahajdin CENA

Do të doja që sot në vendet ku ju jeni të ulur, të qëndrojnë këtu në këtë sallë Ukshin Hoti, Xhemajli Berisha, Besim Ndreca, Behajdin Hallaqi, Remzi Ademi, Xhevat Berisha e Jetullah Qarri e, në vend të rektorit të nderuar, të jenë këtu në mesin tonë edhe Fadil Vata, Jashar Salihu e Kasim Haxhimurati, që mbetën marathonomakë e pëllumba të lirisë, e do të doja që ata sot para nesh t'i flasin këtij auditori intelektualësh dhe akademikësh të tashëm e të ardhshëm.

Por, ja se jeta i paska ligjet e veta, që ne më shumë vështirësi, por edhe më po aq krenari i përballojmë, sepse në rrethanat normale të bijtë i përcjellin në botën e amshueshme prindërit e vet, ndërsa në një çmenduri të këllile me të cilën po ballafaqohemi shumë shpesh nëpër vorbullat e historisë sonë, tash e gjashtë shekuj ne shqiptarët, prindërit që i kemi sot këtu, i përcollën në atë botë bijtë e tyre: Blerimin, Hashimin, Bekimin, Fitimin, Enverin, Muhametin, Hysniun, Sinanin, Sedatin, Isanë, Isakun, Agimin, Ismailin, me më se 250 banorë të Krushës së Madhe, me 125 banorë të Celinës, me 120 banorë të Fortesës, me 50 banorë të Nagavcit, me 65 banorë të Hoçës së Vogël, me 70 banorë të Brestovcit, me 30 banorë të Retisë, Zaçishtit e Apterushës, me 30 banorë të Randubravës, me 120 banorë të Krushës së Vogël, me 130 banorë të Tususit të Prizrenit, me 20 banorë të Landavicës, me 50 banorë të Korishës, me 150 banorë të Therandës e me shumë të tjerë nga Hasi me Has, andej e Has këndej Pashtrikut, prandaj Krusha e Madhe, e Bajram Currit dhe e Ukshin Hotit, gjatë këtyre ditëve u

bë Aushvic e shkuar Ashvicit, e neve na mbetet që gjatë leximit të shkrimeve të prof. Nusret Pllanës, ta kuptojmë të kaluarën tonë të hidhur nëpërmjet dëshmitarëve që janë personazhe të shkrimeve e personalitete të jetës sonë politike, e njëri prej dëshmitarëve është "Djaloshi me dy zemra", djaloshi pa njëzet e një pranvera, pra nëpërmjet Blerim Bajram Nallit, një libër të cilin e kemi përruar kohë më parë në Prishtinë.

Nusret Pllana, gjatë hartimit të monografive të veta ma sillte imazhin e Odiseut të Homerit, i cili gjatë udhëtimit nëpër botën nëntokësore, pas Luftës së Trojesë, takohet me Agamenonin dhe me luftëtarët e rënë në Luftën e Trojes. Nusret Pllana, në një monografi takohet me Blerimin të cilin e ka dëshmitar okular dhe narrator të gjithëdijshëm prandaj rrefimet e Blerimit të Bajram Nallit nga Krusha e Madhe e profesor Ukshin Hotit, janë rrefime në emër të tërë rinisë shqiptare të dërguar në atë botë nga duart e kriminelëve që dëshironin për ta zhbërë Kosovën, vetëm e vetëm që të mos e kalojmë milionëshin sepse kështu e kërkoni planet e Garashaninit, Hartvigut, Akademisë dhe Kishës serbe dhe në fund kështu e kërkonte kryekrimineli, kryekasapi Slobodan Milosheviq.

Gjatë rrefimeve të këtitilla, Blerim Nalli, për shembull, në "Djaloshi me dy zemra", rrefën për lashtësinë ilire, për kohën e Skënderbeut, për Rilindjen Kombëtare Shqiptare, për Lidhjen e Prizrenit, për luftërat e Sulejman Vokshit, për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, për Bajram Currin dhe lëvizjen e kaçakëve, për Lidhjen e Dytë të Prizrenit, për patriotët e shquar të Krushës së Madhe, Nezir Hotin e Isuf Dellovën, për aksionin e mbledhjes së armëve, për demonstratat e vitit 1968, 1981, 1990 e për Ukshin Hotin, për masakrat në Drenicë, për hero-



izmin e familjeve Jashari, Haradinaj e Lleshi, për këngët e Muhamet Malësorit, të Nazmi Sejfullahut e të Sarandë Krasniqit, për recitimet e Bletës e për vargjet e vogëlushëve krushjanë se pa Ukshin Hotin nuk vjen liria. Dhe me të vërtetë, edhe ky cep i lirisë që e gëzojmë sot është i mëngët sepse ende nuk e dimë ku i kemi të vrrarët, ende nuk dimë gjë për krematoriumet serbe, ende nuk dimë gjë për Ukshin Hotin që mbeti as i gjallë e as i varrosur.

Monografitë e prof. dr. Nusret Pllanës, pjesëmarrës të nderuar, mijëra faqe tekstesh e mijëra metra celuloidi të filmuar, kanë qindra komente e fjalë të redaktorëve e të recensentëve. Të gjitha këto janë të pajisur edhe me shumë fotografi familjare të martirëve, të dëshmorëve të kombit e të heronjve të cilët Nusret Pllana i pati bashkëlufëtarë të orëve të para të radhitjes në formacionet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës qysh në Shqiponjën e Fadil Nimanit-Tigris, Agim, Sadri, Myrtë e Driton Zenelit. Pra, librat e Nusret Pllanës kanë një adresë të saktë të burimeve dhe të referencave, për-

fundime të shkurtëra dhe shënime për autorin, për prof. dr. Nusret Pllanën të cilit i shkoi rinia nëpër burgje, e në Luftën e Ushtrisë.

Çlirimtare të Kosovës, në katedrat e universiteteve e tash në fund edhe në fushën e informimit publicistik për t'i treguar botës me shkrime, me libra e me filma se në Kosovë me të vërtetë u bë një gjenocid i paparë dhe sot krushat, prizrenët, gjakovat, qyshkat, izbicat, mbeten aushvica e shkuar aushvicave.

Pra, në shkrime e filma të veçantë të kësaj odiseade nëpër botën nëntokësore ku shtegton profesor Pllana për ta takuar, për ta parë e për ta dëgjuar jo vetëm zërin e Blerimit në blerimin e pranverës, por edhe të shumë blerimeve të tjerë, jetojnë imazhe të tmerrit që na pati katandisur. Këtu janë prekur dhe shpalosur, jo vetëm anët e jetës apo të historisë së një njeriu, aq më pak të një të riu, i cili një ditë pa i mbushur njëzet e një vjet bëhet pjesë e vdekjes që kërkonte liria e kësaj pjesë të atdheut tonë, por edhe gjeografia jonë e tkurrur. Po ashtu, në kapitujt e këtyre monografive janë trajtuar dhe realizuar aspekte nga më të ndryshmet, jo vetëm të atij rrafshi si i janë rrefyer ngjarjet tronditëse. Pra, tërësisht në vetën e parë, si i ka rrefyer, për shembull Blerimi ngjarjet duke bashkëbiseduar edhe me të tashmen e jetës së tij, edhe me jetën e përtejme të tij, në mënyrë që të shpalohej gjithë dhembja, gjithë rrjedha historike e tragjedisë së Krushës së Madhe e të Kosovës, e cila edhe shpalohej në trajtën e një arkivi që lëshon ujë në formë rubinete dhe prej saj dalin të dhënat për lexuesin e informuar dhe të painformuar për atë se ç'ishim, ç'jemi sot e çka mund të jemi nëse shkelim mbi shenjat e kujtesës sonë historike, nëse na kapin përpara valët e një sëmundjeje që quhet harresë.

Pra, pjesëmarrës të nderuar, e këtitillë është jeta, e këtitillë është historia

dhe e këtitillë na doli gjeografia jonë kombëtare në këtë truall që quhet Kosovë e që dita më ditë po na tkurret e po na bëhet lëkurëshqarthe duke filluar prej Kongresit të Berlinit e këtej, prandaj shenjat e kujtesës sonë historike duhet t'i mirëmbajmë, në të kundërtën e kaluara mund të na përsëritet.

Pjesëmarrës të nderuar, Kjo që po promovojmë sot, është vepër më e re e prof. dr. Nusret Pllanës, pas të gjithë atyre shkrimeve duke filluar prej "Radio Kosovës së Lirë" e dëshmorit Agim Bardh Zeneli nga Shqiponja e Dushkajës e deri te "Djaloshi me dy zemra", është fryt i një arkivi e i një shpirti erudit të cilin nuk e lodhi as burgu në kazamatet komuniste e serboçetnike, as lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, prandaj na mbetet që autorit t'i dëshirojmë jetë të gjatë, pleqëri të lumtur, punë të mbarë në përfundimin e të gjitha ndërmarrjeve që i ka nisur apo që i ka në plan për t'i nisur, bashkëpunëtorëve të tij t'u dëshirojmë suksese, e juve të gjithëve gjajretin burrëror e kuvetin ashtu siç ju njoh, ashtu siç ju njoha në të gjitha protestat e deritashme, ashtu siç u njohëm gjatë periudhës së Ukshin Hotit, ashtu siç ju njoha gjatë luftës, prandaj edhe dëshiroj që t'i lexoni këto monografi e t'i shihni dokumentarët e prof. Pllanës sepse:

"Veç një qëllim i lartë të ban me durue E zemrën ta forcon.

Ndër kundërshtime s' vyen kur me u ligstue Mjer ai që nuk qëndron!"

Lavdi të gjithë martirëve anembanë fushëbetëve të trojeve etnike!

Lavdi të gjithë martirëve të Kosovës!

Lavdi martirëve të Prizrenit!

Lavdi dëshmorëve të kombit! Zoti ju forcoftë!



E rrallë

Tualeti publik më i bukur në botë

Në Norvegji është hapur tualeti që mund të konsiderohet si më i bukur në botë. Ky tualet ndodhet në majë të një kodre në Ureddplassen, përgjatë rrugës piktoreske të Helgelandskystenit. Tualeti luksoz pranë qytetit të Gildeskalit ka kushtuar rreth 1.5 milion euro. Me një pamje kah deti, ky tualet me shumë mundësi do të bëhet një atraksion turistik.



FOTO E DITES



Pamje nga qyteti i Pejës, ku shihen edhe bjeshkët e Rugovës. Foto: G. D.

E jashtëzakonshme

Hapet në Kiev i pari hotel dashurie

Ka nisur punën në Kiev të Ukrainës i pari hotel dashurie për të gjitha ato çifte që kërkojnë një natë aventurë të tipit "50 Shades of Grey". Pronari i hotelit, Cherry Twins, premtori për klientët e vet një hapësirë dashurore dhe ofron 7 dhoma për të gjithë ata që duan të luajnë me role.



BARSOLETA E DITËS



Polici dhe vozitësi:

- A ke pirë sot diçka?
- Pse bre polic asnjëherë s'ju shkon mendja me pyet: 'A ke hangër sot diçka?'



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER"

3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.

Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

"PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

"RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenaerts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Dita e sotme do të ketë suksese të njëpasnjëshme në të gjitha fushat. Edhe pse të tjerët ju paragjykojnë pa të drejtë, ju nuk do të mërziteni fare.



DEMI

Do të keni një udhëtim pune që në nisje do të mbartë shumë stres, por kur të përfundojë ju do të jeni fitimtar dhe mjaft të kënaqur.



BINJAKËT

Sot do të jeni shumë të afërt me parterin, që ju kishte munguar kohët e fundit. Atmosfera romantike do të mbizotërojë gjatë gjithë ditës.



GAFORRJA

Për mirëqenien dhe lumturinë brenda mureve të shtëpisë do të jeni gati të bëni gjithçka. Një person afër jush do t'ju japë një këshill të vlefshme.



LUANI

Sot do ta tregoni veten si diplomat në disa çështje, megjithëse keni ndjenja të thella karshi një personi do të arrini të mbani nën kontroll çdo sjellje tuajën.



VIRGJËRËSHA

Në familje do të keni mjaft gjëra për të thënë sa i përket një vendimi që është marrë pa praninë tuaj. Mundohuni të arrini në një zgjidhje.



PESHORJA

Komunikimi është arma juaj fituese në çdo moment. Do të arrini të gjeni mënyra alternative për t'i zgjidhur ngërçet e krijuara në punë.



AKREPI

Përqendrohuni tek faktet sot pa u marrë me fjalë të kota që mund t'ju shpërqendrojnë nga objektivi juaj final.



SHIGJETARI

Sot ju mungon entuziazmi i zakonshëm për t'i bërë gjërat për të cilat keni në mendje.



BRICJAPI

Me kolegët po kaloni kohë shumë të mira falë një bashkëpunimi që sapo keni nisur. Në shoqëri të tyre do të mësoni shumë gjëra.



UJORI

Sot keni nostalgji për të kaluarën dhe për tradicionalen. Pranvera ju sjell më pranë kujtimeve të fëmijërisë që këto ditë po ju shoqërojnë.



PESHQIT

Jeta ka ende shumë gjëra për t'ju ofruar dhe sot do t'ju mbushet mendja për këtë gjë. Do të gjeni arsye të largoheni për pak ditë.

"Rikthehet" Arnold Schwarzenegger



Disa ditë më parë një ndër aktorët më të famshëm në botë, Arnold Schwarzenegger, iu nënshtrua një ndërhyrje kirurgjikale në zemër. Operacioni ishte për ta zëvendësuar një valvul që

fillimisht ishte zëvendësuar 20 vjet më parë. Duket se për aktorin 70-vjeçar gjithçka ka shkuar mirë dhe, sipas zëdhënësit të tij, Arnoldi gëzon shëndet të plotë. Aktori ka folur me familjarët duke thënë: "Unë jam kthyer".

Ndahen pas nëntë vjetësh martesë



Channing Tatum dhe Jenna Dewan Tatum kanë njoftuar për vendimin e tyre për t'u ndarë pas pothuajse nëntë vjetësh martesë. Aktori 37-vjeçar dhe aktoria 37-

vjeçare u takuan në vitin 2006 dhe u martuan në vitin 2009. Channing dhe Jenna janë prindër të vajzës me emrin Everly, e cila do të bëhet pesëvjeçare muajin e ardhshëm.



Rita Ora duket si lepurushe

Rita Ora ka shijuar momentin e saj si një lepurushe për Pashkët këtë fundjavë. E fotografuar nga Damon Baker, këngëtarja është shfaqur më seksi dhe lozonjare

se kurrë duke ngrënë çokolatë. Në fotografitë e publikuara në llogarinë e saj në "Instagram", 27-vjeçarja dukej e mrekulueshme, e veshur me të brendshme e veshë lepurushi.

Sukseset për The Weekend s'kanë të ndalur



The Weekend ka shpenzuar shumicën e kohës javën që shkoi duke paralajmëruar debutimin e projektit të tij më të ri, e fansat mezi e prisnin një gjë të tillë. Shumica menduan se The

Weekend do ta publikojë këngën e tij më të re gjatë fundjavës që shkoi. Megjithatë, këngëtari publikoi gjashtë këngë të reja nga projekti i tij më i ri "My Dear Melancholy".

EURO GLASS
SAINT-DOMAIN
SEKURITË
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

LIVERPOOL - MAN CITY

GG3+

BARCELONA - ROMA

3+

RENNES - MONACO

2

Vushtrria, gati ta befasojë edhe Prishtinën

Sot (e mërkurë) nga ora 14:00 zhvillohen dy ndeshjet e para gjysmëfinale në garën e Kupës në futboll. Prishtina e pret Vushtrrinë në Pejë, kurse derbi i skuadrave kuqezi, Drenica - Vëllaznimi, zhvillohet në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 PRILL - Skuadra e Ligës së Parë, Vushtrria, është e gatshme ta vazhdojë ecurinë fantastike në garën e Kupës edhe përkundër faktit se përballë e ka skuadrën e Prishtinës. Kapitani i vushtrriasve, Labinot Osmani, i cili në të kaluarën ka qenë pjesë e Prishtinës, ka thënë se triumfi ndaj skuadrave të Superligës konfirmon se ndaj Vushtrrisë duhet pasur respekt, kurse për ndeshjen ndaj Prishtinës është optimist se skuadra e tij mund t'ia arrijë qëllimit që ta eliminojë nga gara e Kupës. "Ecuria jonë në garën e Kupës s'vjet ka qenë e suksesshme. Këtë e them për faktin se ekipet e Superligës kanë qenë favorite dhe mjaft të organizuara, kurse ne ia kemi dalë t'i eliminojmë. Sigurisht se synimet tona janë të rikthehemi në Superligë, por edhe në Kupë do t'i kemi shanset tona. Përballë e kemi një kundërshtar që gjithmonë kërkon

trofe, por do të mundohemi të paraqitemi mirë, pse jo edhe ta eliminojmë", ka thënë Osmani për "Epokën e re". Për ndeshjen gjysmëfinale të Kupës ka folur edhe mbrojtësi i Prishtinës, Lorik Maxhuni. Ky i fundit ka thënë se kryeqytetasit nuk bënë të gabojnë ndaj Vushtrrisë, pasi synim e kanë finalen. "Është kjo ndeshje shumë me rëndësi për ne. Kundërshtarin e vlerësoj shumë pasi, për të ardhur deri në gjysmëfinale, ka eliminuar jo rastësisht dy ekipe të Superligës. Pra, ne duhet t'i qasemi dhe të jemi të përqendruar maksimalisht në ndeshje duke e bërë detyrën për të vazhduar drejt qëllimit që kemi përpara, në finale të Kupës", ka thënë Maxhuni. Krahas ndeshjes Prishtina - Vushtrria që zhvillohet në Pejë, në kuadër të gjysmëfinalës së Kupës zhvillohet edhe ndeshja në mes të Drenicës dhe Vëllaznimit. Përballja e skuadrave kuqezi do të jetë në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj.



UEFA inspektion stadiumin e Prishtinës

Zyrtarë të UEFA-s pritet që sot (e mërkurë) t'i inspektojnë punimet në stadiumin e Prishtinës, i cili ka filluar të rinovohet që nga viti 2016. "Të mërkurën nga ora 15:30 zyrtarë të UEFA-s inspektojnë punimet në stadiumin e qytetit në Prishtinë,

ku do të marrë pjesë edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi", thuhet në njoftimin e MKRS-së. Sipas paralajmërimeve të drejtuesve të sportit, ky stadium pritet të jetë gati në muajin qershor.

MKRS-ja nënshkruan memorandume edhe me gjashtë federata



PRISHTINË, 3 PRILL - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, në kuadër të mbështetjes financiare për federatat sportive, ka nënshkruar të martën memorandume bashkëpunimi edhe me gjashtë federata të tjera. Federata e Gjymnastikës mbështetet financiarisht me 47 850 euro, për të cilën nënshkroi kryetari i federatës, Besim Halilaj. Me Federatën e Minigolfit u nënshkrua memorandum bashkëpunimi për mbështetjen

financiare në vlerën e 12 800 eurove. Për këtë federatë nënshkroi kryetari i federatës, Lavdim Zylfiu. Federata Aeronautike, e përfaqësuar nga kryetari i federatës, Shkëlqim Krasniqi, mbështetet me 32 120 euro. Në emër të Federatës së Shigjetarisë, kryetari i federatës, Agron Mala, nënshkroi memorandum për përkrahje financiare në vlerë mbi 67 mijë euro. Po ashtu, Federata e Atletikës mbështetet financiarisht me mbi 85 mijë euro. Për këtë federatë nënshkroi kryetari i feder-

atës, Halil Sylejmani. Ndërkaq për Federatën e Ping-Pongut kryetari i kësaj federate, Nehat Çitaku, nënshkroi memorandum me vlerë financiare prej 72 mijë eurove. Ministri Kujtim Gashi ka thënë se po punon që, duke përkrahur financiarisht këto federata, të ndihmohet sporti i Kosovës. Ndërkaq drejtuesit e federatave përkatëse vlerësuan se kjo formë e bashkëpunimit në mes të MKRS-së dhe federatave të tyre u mundëson menaxhim më të mirë të mjeteve financiare.

Vokri: Miqësorja me Shqipërinë, e mundshme

PRISHTINË, 3 PRILL - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokri, ka konfirmuar se ka pasur bisedime me drejtuesit e Federatës Shqiptare të Futbollit

(FSHF) për zhvillimin e një ndeshje miqësore. "Kemi biseduar një herë, por jo për të gjitha detajet. Është e mundshme të luhet një miqësore kundër

Shqipërisë, por ende asgjë nuk ka konkrete. Shqipëria ka një ndeshje me Ukrainën dhe ne nuk e dimë se si do të procedojmë, meqenëse presim të luajmë një

miqësore, nëse stadiumi i Prishtinës do të përfundojë. Jemi në dilema të mëdha jo për shkak tonin, por për shkak të stadiumit", ka thënë Vokri.



Messi: Spanja, Brazili dhe Gjermania, favoritë në 'Rusi 2018'

BARCELONË, 3 PRILL - Lionel Messi ka folur për Kampionatin Botëror "Rusi 2018", ndërsa nuk e ka fshehur se synon triumfin me Argjentinën. Pesë herë fituesi

i "Topit të Artë" pranon se gara për të ngritur Kupën e Botës nuk do të jetë aspak e lehtë, ndërsa nxori edhe emrat e tri skuadrave favorite. "Synimi ynë është të shkojmë

në finale dhe ta fitojmë atë. E dimë shumë mirë që për ta arritur, duhet të luftojmë shumë në çdo ndeshje, njëkohësisht shpresojmë që këtë herë të fitojmë, ndryshe

nga finalja e Brazilit. Personalisht mendoj se tri kombëtares favorite për ta fituar kampionatin janë Spanja, Brazili dhe Gjermania", ka thënë Messi.



Liverpool - City, derbi anglez në Ligën e Kampionëve

LIVERPOOL, 3 PRILL - "Anfield Road" është gati të bëhet arenë e një çerekfinaleje të gjitha angleze në Ligën e Kampionëve. Askush nuk mund të kërkonte më shumë. Liverpooli do ta presë skuadrën që do të jetë kampione e Anglisë. Është hera e parë në historinë e këtyre dy ekipeve që ndeshen për Kupat e Evropës. Manchester City luan për herë të dytë në çerekfinalelet e Ligës së Kampionëve, ndërsa për Liverpoolin është ndeshja e nëntë në këtë raund të veprimtarisë prestigjioze. Të dy klubet janë ndeshur dy herë në Premier Ligë në këtë sezon, me nga një fitore secila dhe me plot 12 gola të shënuar, me avantazhin e City 8-4 në golaverazh, raporton "Telesport".

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka folur me shumë respekt për Pep Guardiolan. "Ai gjithmonë ka pasur në dispozicion skuadra të mëdha me futbollistë të mëdhenj që bëjnë zgjidhjen e duhur kur kanë topin në zotërim. Diferenca mes ekipeve që ai ka drejtuar dhe ekipeve të mia nuk ka qenë kurrë kaq e vogël sa sivjet", ka thënë Klopp, i cili mund të krenohet me faktin se është trajneri që ka fituar më shumë ndeshje kundër Guardiolas si kundërshtar. Ai e ka mposhtur gjashtë herë spanjollin në 12 përballje, ndërsa Pep ka fituar pesë ndeshje. Për më tepër, Liverpooli është kualifikuar në 9 nga 13 çerekfinalelet që ka luajtur në Kupat e Evropës, dy herë ka eliminuar pikërisht skuadra nga Anglia. "Të kuqtë" do t'i kenë shpresat



kryesore të Mohamed Salah, i cili ka tundur rrjetën në 11 nga 15 ndeshjet e fundit që ka luajtur, për një total prej 17 golash gjatë kësaj periudhe. Nga ana tjetër, ish-futbollisti i Liverpoolit, Raheem Sterling, ka shënuar katër gola për Manchester Cityn në këtë sezon të Ligës së Kampionëve, gjithashtu shënoi gol në fitoren 3-1 gjatë fundjavës së kaluar në "Goodison Park", vetëm 400 metra larg nga "Anfield Road". Vlen për t'u përmendur se Manchester City dhe Liverpooli janë ekipet që kanë shënuar më shumë gola në këtë edicion të Premier Ligës, 88 për Cityn dhe 75 për Liverpoolin. Këta të fundit mund të krenohen se kanë shënuar 28 gola në Ligën e Kampionëve, më shumë se çdo ekip tjetër në këtë edicion. Gjashtë përballjet e fundit në mes të Liverpoolit dhe Cityt kanë prodhuar 23 gola (3.83 gol/ndeshje), 22 kartonë të verdhë (3.67

karton/ndeshje) dhe 1 karton të kuq.

Barça, favorite ndaj Romës

Në ndeshjen tjetër që zhvillohet sonte në "Camp Nou", Barcelona e pret skuadrën e Romës. Italianët kanë tejkaluar parashikimet duke arritur deri në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, por Barcelona shihet si favorite në këtë ndeshje dhe favorite edhe për kualifikim në gjysmëfinale. Barça e udhëheq kampionatin në Spanjë dhe me shumë gjasë do të triumfojë, kurse Roma në Itali është në pozitën e tretë dhe do t'i duhet shumë "luftë" me Lazio e Interin për ta ruajtur këtë pozitë deri në fund.

TË MËRKURËN TAKOHEN:
20:45 Barcelona-Roma
20:45 Liverpool-Manchester City

Milan - Inter, sfida që fiton botën

MILANO, 3 PRILL - Derbi i "Madonnina"-s në mes të Milanit dhe Interit nuk është si ai i viteve të kaluara, por kjo nuk e ka ulur aspak interesin e tifozëve të futbollit. Edhe pse nuk janë në pozitë që kanë pasur dikur, Milani dhe Interi vazhdojnë të kenë admiruesit e tyre dhe ta ndajnë Milanon në dy pjesë. Por, interesi për këtë sfidë është i madh edhe jashtë Italisë. Në fakt, sfida e së mërkurës do të transmetohet në 181 vende të botës dhe do të mbërthejë para ekranit 728 milionë persona. Ata që janë më me fat, janë 75 mijë personat që kanë mundur t'i gjejnë biletat për ta ndjekur këtë supersfidë në shkallët e "Giuseppe Meazzas" në "San Siro". Interesi për derbin e "Madonninës" do të jetë i madh



edhe në Hong Kong apo Kinë, vendet ku banojnë presidentët kinezë të dy klubeve, ndërkohë që kjo ndeshje pa dyshim do të transmetohet në të gjithë Evropën dhe Afrikën. Ndeshja mes Milanit dhe Interit merr një vlerë shumë të madhe për të dyja skuadrat. Kuqezinjët janë 8 pikë larg Interit dhe një fitore ndaj zikaltërve u jep mundësinë të mbajnë gjallë ëndr-

